ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **TK-23-4036-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Gent Gorani**
NUI	**810956724**
Adresa	**Muharrem Fejza relax**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**049752100**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Gent Gorani**
Adresa elektronike	**gentigorani@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**09.01.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio

16.05.2023 Njoftim per kontrat

08.06.2023 14:00 Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje

16.05.2023 Njoftim per Kontrat

08.06.2023 14:00 Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje

20.07.2023 14:35 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues

25.07.2023 Kerkesa per Rishqyrtim

27.07.2023 Refuzimi i kerkeses per rishqyrtim

27.11.2023 Vendimi i OSHP

20.12.2023 Vendimi i AK 2

27.12.2023 Refuzimi i kerkeses per rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me daten 26.12.2023 kemi parashtruar Kerkesen per Rishqyrtim dhe me daten 27.12.2023 kemi pranuar refuzimin e kerkeses.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

PRETENDIMI 1)

Neni 59
Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

Lista e çmimeve nuk është plotësuar - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrativ
Udhëzues Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik
10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.
10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së. Lista e çmimeve nuk është plotësuar - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion 7 të mëtejshëm - Kusht administrativ.
2) Neni 44 Formularët Standard. 44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI 1)

Perseri kemi te bejme me te njejtin pretendim si ne ankesen e meparshme sa i perket te njejtit aktivitet te prokurimit.
Pra, pretendimi yne te cilin edhe OSHP e vleresoi si te bazuar sa i perket Mos plotesimit te Formulareve Standard sipas kerkesave/specifikimeve te vendosura nga AK.

OE i shpallur fitues njejte si OE te tjere te eliminuar nga gara nuk ka plotesuar Formularin standard - Lista e çmimeve sipas kerkesave/specifikimeve te kerkuara nga AK.
Pra, OE "Q.M TEMA" nuk ka plotesuar sipas kerkesave dhe sipas normave e ligjeve te RKS-se kolonat:
1) NORMA E TVSH - nuk ka plotesuar kete kolone sipas kerkesave/specifikimeve teknike dhe as sipas Normave te percaktuara nga ligjet e RKS.
2) SHENIM OPERATORI EKONOMIK - Nuk ka plotesuar kolonen me shenimin e OE, por ka vendosur shenjen NA - e cila nenkupton "NO ANSWER."

Jemi shume te habitur me faktin se si AK edhe ne fazen e rivleresimit nuk respekton vendimin e OSHP-se, me te cilin ishin pajtuar me mendimin e ekspertit perkatesisht piken:
Mosplotësimi i kushteve teknike dhe Formularit standard - Lista e çmimeve sipas specifikimeve konsiderohet si një mosplotësim i kërkesave të dosjes se tenderit dhe ndikon negativisht në vlerësimin e ofertës nga OE te eliminuar nga AK. Ky tejkalim gjate vlerësimit nga komisioni vlerësues dërgon në diskualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankues nga gara ose vlerësimin e tyre si ofertë jo e suksesshme.Për të qenë konkurrues në një procedurë të prokurimit publik, operatorët ekonomikë duhet të sigurohen që të plotësojnë të gjitha kushtet e kërkuara dhe të prezantojnë një ofertë të plotë dhe të rregullt në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktues.

Edhe me shqetesuese eshte fakti se OE "Q.M TEMA" shpallet fitues edhe pse tenton te beje evazion fiskal duke ofertuar PA TVSH, ani pse ne ATK eshte i regjistruar si

deklarues i TVSH-se.
AK pretendon se kemi te bejme me gabime ne percaktimin e normes se TVSH-se, mirepo ne kete rast OE qartazi oferton pa tvsh per te gjitha pozicionet ne listen e cmimeve, si dhe Formularin e tenderit e ploteson pa TVSH poashtu.
Ky OE te njejten shkelje e praktikon edhe ne aktivitetet tjera publike ku ne te gjithat oferton pa TVSH.
Me poshte gjeni nje aktivitet tjeter ku ky OE ka qene pjesemarres dhe oferton pa TVSH.

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TE

mri i prokurimit curement number j nabavke:	**216-23-10667-2-2-1**	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	**Prodhimi i videove promovuese**
mri i brendshëm ernal No erni broj			

e lëshimit of issue m izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëv No. of Receiv Br. Primljenil
1.2023	**03.11.2023, 13:30:00**	**03.11.2023, 13:30:00**	**MPJD**	**4**

	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshim Suplemen Dpuna/Izı
	Grup i Operatorëve Ekonomik MOVIOLA L.L.C.; PLATFORM ADVERTISING L.L.C., Rruga Isa Kastrati, 10000, Prishtine	**216-23-10667-2-2-1**	**Prodhimi i videove promovuese**	**PO**	**21101.69**	**24900.00**	
	N.SH. " 2 B ", AHMET KRASNIQI,BLL.C2-10 OBJ."B", 10000, PRISHTINË	**2b**	**Prodhimi i videove promovuese**	**PO**	**24669.49**	**29110.00**	
	KARROTA ADS SH.P.K., rr. Tirana, Kompleksi Ramiz Sadiku, 10000, Prishtine	**KRT03112023**	**Prodhimi i videove promovuese**	**PO**	**45182.00**	**55100.00**	
	Q.M. "Tema", Dëshmorët e Kombit nr.36, 70000, FERIZAJ	**QM TEMA OP**	**Prodhimi i videove promovuese**	**PO**	**17990.00**	**17990.00**	

Poashtu, vlen te theksohet se ne rast te permiresimit te Normes se TVSH-se, atehere kemi mosperputhje te cmimit per njesi pa tvsh (cmim mbizoterues) dhe cmimit total me TVSH (cmimit me te cilin vleresohet tenderi) dhe keshtu gabimi aritmetikor eshte 18% dhe shpie direkt ne eliminimin e ketij OE te papergjegjshem.

Ne tentuam te ia sqarojme AK-se se OE i shpallur fitues, ka thyer edhe Ligjet e leshuara nga institucionet e larta shteterore dhe jo vetem LPP.
Andaj, nenshkrimi i kesaj kontrate ka baze ligjore per evazion fiskal dhe demtim te drejtperdrejte te buxhetit te RKS.
Ky vendim eshte poashtu diskriminues ndaj tatimpaguesve te rregullt te RKS.

Me poshte gjeni edhe kerkimin e OE ne webfaqen zyrtare te ATK-se, ku i njejti figuron si deklarues i TVSH-se, ndersa tenton te beje evazion fiskal duke pranuar te nenshkruaje nje kontrate per te cilen ka ofertuar PA TVSH.

Nr. TVSh	330075988
Statusi në TVSh	DEKLARUES I TVSH
Nr. Fiskal / NRB	810645591 810645591
Emri	Q.M. "Tema"

Me poshte gjeni Listen e cmimeve te dorezuar nga OE "Q.M TEMA":

Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi	Norma e TVSH-së	Çmimi për njësi me TVSh	Sasia	Njësia matëse	Totali	Totali (me TVSh)	Totali TVSh	Titulli prodhues	Shënim operatori ekonomik	
1	Reklamat për televizion prej të janë nga 20 deri në 60 sekonda e realizuar me kamerë 4K në formatin HD për transmetim në TV	2,500.00	0.00	2,500.00	6.00	copë	15,000.00	15,000.00	0.00	Reklamat 4K	NA	MUNGON PLOTESIMI I NORMES 18%
2	Reklamat për televizion (10-40) të realizuara ne formë animative (ose edhe të kombinuar me xhirim, kamerë) ne formatin 3D	3,500.00	0.00	3,500.00	4.00	copë	14,000.00	14,000.00	0.00	Reklamat Composite	NA	
3	Reklamat të vogla animacione ne tekniken 3D dhe 2D kombinim	3,000.00	0.00	3,000.00	6.00	copë	18,000.00	18,000.00	0.00	Reklamat Mini 3D+2D	NA	MUNGON SHENIMI I OE
4	Radio reklama	300.00	0.00	300.00	6.00	copë	1,800.00	1,800.00	0.00	Radio ads	NA	
5	Jingles Animacione 2D	1,000.00	0.00	1,000.00	5.00	copë	5,000.00	5,000.00	0.00	CG Jingles	NA	
6	Njoftime Annoucement IVR dhe te ngjajshme (VOICE)	25.00	0.00	25.00	700.00	min	17,500.00	17,500.00	0.00	PSA	NA	

PERFUNDIM:
Kerkojme nga OSHP, qe kete lende ta vleresoje si te bazuar dhe ta trajtoje si "res judicata", pasi qe pretendimi eshte gjykuar me pare, dhe lenda te kthehet ne rivleresim perseri.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkelja e supozuar kercenon te na shkatoje deme materiale, si shpenzimet e pergaditjeve te ankesave.

Mirepo shkelja e supozuar rrezikon te shkaktoje deme drejteperdrejt ne buxhetin e RKS.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*